

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7109
E hënë, 5 shkurt 2024
Çmimi 0.50

PDK-ja me deklaratë politike
vendos për mobilizim të
strukturave për zgjedhjet e
reja parlamentare | F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HOVENIERI THOTË SE SHBA-ja ËSHTË E SHQETËSUAR ME VEPRIMET E FUNDIT TË QEVERISË SË KOSOVËS | F. 4-5



Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë thellësisht të shqetësuara për veprimet e fundit të autoriteteve të Qeverisë së Kosovës, që kanë një efekt të drejtpërdrejtë dhe negativ ndaj pjesëtarëve të serbëve etnikë dhe komuniteteve të tjera pakicë në Kosovë. Ai ka shprehur edhe shqetësimin për veprimet e Policisë së Kosovës për sekuestrimin e dinarëve serbë dhe veturës që transportonte shpërndarjen e pagesave sociale nga Serbia. Edhe Bashkimi Evropian i bëri thirrje të dielën Kosovës t'i shmangë veprimet e njëanshme, që mund t'i rrisin tensionet

ROLI I ISH-të BURGOSURAVE POLITIKE NË LËVIZJEN E PAJTIMIT TË GJAQEVE 1990-1991 NË KOSOVË | F. 3

Në vitin 1990 vajzat shqiptare, të cilat kishin kaluar vite të tëra të rinisë nëpër burgje si të burgosura politike, ia hapën vetes edhe një derë tjetër të barazisë gjinore: atë të pjesëmarrjes në pajtimin e gjaqeve. Ajo kishte qenë e mbyllur për to duke filluar nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, Besëlidhja e Lezhës, e Prizrenit, e Pejës...

Lulëzim ETEMAJ



AKTUALE



ZËVENDËSKRYEMINISTRJA REXHEPI:
PROJEKT-STATUTI AKTUAL I
ASOCIACIONIT KRIJON HAPËSIRË
PËR NJË REPUBLIKË SERBE | F. 3

ZELENSKY E VIZITON VIJËN
E FRONTIT, MES SPEKULIMEVE PËR
FATIN E GJENERALIT TË LARTË | F. 6

HAZIRI: KOSOVA HUMBI DY ÇASTE
PËR TA DETYRUAR SERBINË TA
NDRYSHOJË KUSHTETUTËN E SAJ | F. 7

EKONOMI



RREGULLORJA E RE, BQK-ja TREGON
SE KU DHE SI MUND TË BËHET
PRANIMI DHE KONVERTIMI NË EURO | F. 8

HAPEN OFERTAT E ANKANDIT
TË PARË SOLAR FOLTOVOLTAIK
PREJ 100 MW | F. 8

SPORT



YLLI NUK GABON NDAJ PRIZRENIT,
PEJA TRIUMFON NË DERBI | F. 10

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky e viziton vijën e frontit, mes spekulimeve për fatin e gjeneralit të lartë

KIEV, 4 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i ka vizituar trupat ukrainase në vijën e frontit në juglindje të vendit dhe ka shpërndarë medalje, njoftoi zyra e tij të dielën.

Vizita e tij u bë në një kohë spekulimesh se shefi i famshëm i ushtrisë ukrainase mund të shkarkohet. "Kam nderin të jem këtu sot për t'i mbështetur luftëtarët dhe për t'i shpërblyer ata. Ata përballesh me mision të vështirë dhe kritik për ta zmborsur armikun dhe për ta mbrojtur Ukrainën", tha

Zelensky në një komunikatë, pasi e vizitoi rajonin e Zaporizhjas.

Presidenca ukrainase tha se Zelensky i vizitoi pozicionet ushtarake ukrainase në afërsi të fshatit Robotine, i cili ndodhet pothuajse në vijën e frontit.

Pjesa juglindore e Robotines u çlirua në fund të gushtit gjatë kundërofensivës ukrainase kundër forcave ruse. Zelensky e vizitoi frontin e betejës në një kohë pasigurish për fatin e shefit të ushtrisë ukrainase, Valeriy Zaluzhny.

Sipas Reuters, qeveria ukrainase

e kishte njoftuar Shtëpinë e Bardhë të premten se po planifikon ta shkarkojë komandantin kryesor të ushtrisë, i cili është udhëheqës i luftës kundër forcave pushtuese ruse.

Dyshimet për shkarkimin e Zaluzhny, i cili ka pasur mospajtime me Zelenskyn për një sërë çështjesh, pasojnë pas kundërofensivës ukrainase të vitit të kaluar, e cila dështoi ta çlirojë shumicën e territorit të pushtuar nga Rusia. I njohur si "gjenerali i hekurt", Zaluzhny është tejet i popullarizuar.



Së paku 46 të vdekur si pasojë e zjarreve në Kili

SANTIAGO, 4 SHKURT - Së paku 46 njerëz kanë vdekur si pasojë e zjarreve që janë përhapur në një pjesë të banuar dendësisht në Kilin qendror, ka njoftuar presidenti i Kilit, Gabriel Boric.

Zyrtarët kilianë kanë thënë se së paku 1 100 shtëpi janë shkatërruar nga zjarret.

Duke folur për televizionin publik, presidenti kilian paralajmëroi se numri i të vdekurve mund të rritet për shkak të përhapjes së katër zjarreve në rajonin Valparaiso, ku zjarrfikësit po kanë vështirësi të arrijnë në lagjet më të rrezikuara.

Boric u bëri thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë me ekipet e shpëtimit. "Nëse ju kërkohet të evakuoheni, mos ngurroni.



Zjarret po përhapen me shpejtësi dhe kushtet klimatike mund ta bëjnë të vështirë shuarjen e tyre. Temperaturat janë të larta, erërat

të forta, ndërsa lagështia e ulët", u tha Boric kilianëve.

Ministrja e Brendshme e Kilit, Carolina Toha, tha se 92 zjarre

pyjore janë duke u djegur në pjesët qendrore dhe jugore të vendit, ku temperaturat janë ngritur në mënyrë të pazakontë këtë javë.

Rajoni i Valparaiso u godit nga zjarret më vdekjeprurëse, prandaj autoritetet u kanë bërë thirrje mijëra banorëve të evakuohen nga shtëpitë e tyre.

Në Villa Independencia, një lagje buzë kodrës në cepin lindor të Valparaisos, u shkatërruan disa shtëpi dhe biznese. Veturat e djegura me xhama të thyera u panë nëpër rrugë, të cilat ishin të mbuluara me hi. "Unë jetoj këtu që 32 vjet dhe kurrë s'e kam paramenduar se kjo do të ndodhte", tha Ronaldo Fernandez, një banor të cilit zjarri

ia dogji shtëpinë.

Ai tha se së pari e pa një zjarr duke u djegur në një kodër në afërsi të premten dhe brenda 15 minutave e tërë zona u kaplue nga flaka dhe tymi, duke i detyruar të gjithë të ikin për të shpëtuar. "Kam punuar tërë jetën dhe tani nuk më ka mbetur asgjë", shtoi ai.

Tri strehimore u vendosën në rajonin e Valparaisos dhe u sollën 19 helikopterë dhe më shumë se 450 zjarrfikës për të ndihmuar në shuarjen e zjarrit, tha Toha.

Fenomeni natyror i klimës, El Ninjo, ka shkaktuar thatësira dhe temperatura më të nxehta se zakonisht përgjatë pjesës perëndimore të Amerikës Jugore këtë vit, duke e rritur rrezikun për zjarre pyjore.

ShBA-ja e Britania kryejnë sulme të reja ndaj caqeve të grupit të mbështetur nga Irani në Jemen

WASHINGTON, 4 SHKURT - Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe kanë kryer sulme të reja ajrore kundër objektivave iraniane të shtunën vonë, duke i goditur 36 caqe të grupit rebel, Huthi, në Jemen, dhe duke e përmbushur zotimin se do t'i vazhdojnë veprimet ushtarake ndaj grupeve të cilat i kanë sulmuar interesat e Perëndimit në rajon.

Në një komunikatë për medie, ShBA-ja tha se sulmet u kryen nga luftanijet dhe nga avionët luftarakë.

Sulmet janë pjesë e përgjigjes hakmarrëse të Shteteve të Bashkuara, pas një sulmi me dron në Jordani muajin e kaluar, ku u vranë tre ushtarë amerikanë.

Për këtë sulm Uashingtoni e fajësoi Iranin dhe aleatët e tij që veprojnë në Siri dhe Irak.

Sipas njoftimit, 13 lokacione të ndryshme në Jemen u goditën nga avionët luftarakë amerikanë

F/A-18 dhe nga luftanijet amerikane në Detin e Kuq.

Të shtunën zyrtarët amerikanë thanë se besojnë se sulmet ajrore ndaj dhjetëra zonave të lidhura me Iranin në Siri dhe Irak të premten ishin të suksesshme dhe paralajmëruan sulme të tjera shtesë.

Aleatët e Shteteve të Bashkuara i mbështetën veprimet e Uashingtonit, ndërsa Irani, Iraku dhe Siria shprehën zemërim në një kohë shqetësimesh për përhapjen e konfliktit në rajonin e Lindjes së Mesme.

Britania e Madhe dhe Polonia lëshuan deklaratë në mbështetje të sulmeve amerikane, duke thënë se ShBA-ja ka të drejtë të përgjigjet ndaj sulmeve dhe i paralajmëruan përfaqësuesit e Iranit në rajon se "ata po luajnë me zjarr".

Teherani tha se i dënon "fuqishëm" sulmet ajrore



amerikane.

Iraku njoftoi të shtunën se e ka thirrur në takim të ngarkuarin amerikan me detyrë në Bagdad në shenjë proteste.

Raportimet nga Iraku dhe Siria sugjeruan se rreth 40 njerëz janë vrarë në sulmet në shtatë zona,

katra në Siri dhe tri në Irak të shtunën.

Më herët, Bagdadi tha se 16 trupa të një force shtetërore të sigurisë, e njohur si Forca e Mobilizimit të Popullit, e cila përfshin edhe entitete të mbështetura nga Irani, janë vrarë gjatë sulmeve.

Paraprakisht kishte thënë se në mesin e të vrarëve ka edhe civilë.

Kryetari i Vëzhguesit Sirian për të Drejtat e Njeriut me bazë në Britani të Madhe, Rami Andulrahman, tha se 23 roje në zonat e shenjëstruara janë vrarë.

Presidenti amerikan Joe Biden kishte paralajmëruar ndërhyrje të pashmangshme, pasi një sulm me dron në bazën amerikane në Jordani i vrau tre ushtarë amerikanë më 28 janar. "Përgjigja jonë filloi sot. Do të vazhdojë në vendet dhe në kohët që ne zgjedhim", tha presidenti amerikan Joe Biden në një komunikatë pak pas fillimit të sulmeve të së premtes. "Shtetet e Bashkuara nuk kërkojnë konflikt në Lindjen e Mesme, apo diku tjetër në botë. Por, ata të cilët mund të kërkojnë të na bëjnë dem neve, ta dinë këtë: Nëse e lëndoni një amerikan, ne do të përgjigjemi", tha Bideni.

PDK-ja me deklaratë politike, vendos për mobilizim të strukturave për zgjedhjet e reja parlamentare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHKURT - Me ftesë të kryetarit Memli Krasniqi, Partia Demokratike e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e Këshillit Drejtues, ku është marrë vendimi për mobilizimin e të gjitha strukturave për zgjedhjet nacionale.

Kryetari Krasniqi ka thënë së prioritet i PDK-së është mobilizimi për zgjedhjet e përgjithshme për ta kthyer Kosovën në binarët e zhvillimit.

"Ju ftoj që ta shtojmë dinamikën e punës, ta rrisim përkushtimin edhe më shumë, për të qenë pranë qytetarëve anekënd Kosovës, për ta rikthyer besimin e tyre dhe për t'i dhënë vendit, pas zgjedhjeve të ardhshme, bashkërisht me të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, një qeveri të re që e rikthen Kosovën në binarët e zhvillimit, integritetit dhe perspektivës për të gjithë", shtoi Krasniqi.

Më tutje, në vendimin e Partisë Demokratike të Kosovës thuhet se mandati i strukturave lokale dhe strukturave të tjera të partisë vazhdohet deri në zgjedhjet e brendshme, të cilat do të mbahen menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve nacionale.

Në këtë mbledhje, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, theksoi se viti 2023 ishte viti i humbur për Kosovën në çdo aspekt, dhe e keqja më e madhe që qeveria Kurti ia ka sjellë vendit është pranimi i draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që përmban kompetenca të qarta ekzekutive. "Rrjedhimisht, Partia Demokratike e Kosovës nuk mund ta mbështesë një propozim të tillë, që vjen si pasojë e gabimeve dhe paaftësisë së kryeministrit dhe qeverisë për t'i arritur qëllimet tona shtetërore në procesin e dialogut. Ky proces nuk ka arritur të prodhojë rezultate pozitive për Kosovën gjatë viteve të fundit dhe është karakterizuar me

humbje të ambicies edhe nga partnerët ndërkombëtarë, gjë që ka rezultuar me Marrëveshjen e Ohrit që nuk adreson as për së afërmi kërkesat dhe qëllimet tona të përbashkëta. Në këtë kontekst, Partia Demokratike e Kosovës angazhohet për resetim të procesit të dialogut dhe beson se vetëm një marrëveshje finale dhe gjithëpërfshirëse, ligjërishit e obligueshme dhe e garantuar ndërkombëtarisht, e përqendruar në njohjen reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ruan karakterin unitar të shtetit tonë, brenda rregullimit aktual kushtetues, mundëson paqe të qëndrueshme dhe avancim konkret të integritetit euroatlantik të Republikës së Kosovës", tha Krasniqi.

Lidhur me këto diskutime, Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës ka miratuar Deklaratën, e cila përmban 7 pika: 1. Shteti i Kosovës, integriteti, sovraniteti dhe siguria e tij po vazhdojnë të cenohen nga synimet hegjemoniste të Serbisë. Kjo situatë po rëndohet edhe më shumë nga sjellja dhe veprimet e papërgjegjshme të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, si dhe nga paaftësia dhe keqqeverisja e ministrave të qeverisë së tij. Ekonomia, shëndetësia, arsimit, drejtësia dhe të gjithë sektorët tjerë janë në regres të vazhdueshëm dhe po dëmtohen çdo ditë. Kostoja e jetesës për qytetarët e Kosovës është bërë e papërbalueshme, çka po shërben si arsye për rritjen enorme të numrit të tyre që po largohen nga Kosova. Kosova nën sanksione, vazhdon t'i ketë raportet e tensionuara me partnerët ndërkombëtarë, si pasojë e keqqeverisjes dhe papërgjegjësisë së Qeverisë. Rruga për anëtarësim në BE, në NATO dhe organizata tjera ndërkombëtare, me këtë Qeveri dhe këta zyrtarë, është e pamundur. 2. Përmes veprimeve



të papërgjegjshme dhe të rrezikshme, kryeministri ka braktisur besimin dhe interesin e qytetarëve. Qytetarët e Kosovës mbeten mirënjohës ndaj SHBA-së, BE-së, Shqipërisë dhe partnerëve të tjerë. PDK beson që e vetmja mënyrë për të shpëtuar Kosovën dhe të arriturat historike me shumë mund dhe sakrificë, është mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme, sa më parë, si dhe formimi i një qeverie të re që do të kthejë Kosovën në rrugën e drejtë të zhvillimit dhe integritetit euroatlantik. 3. Në seancat e Kuvendit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës do të votojë vetëm për vendimet me rëndësi strategjike për shtetin dhe qytetarët e Kosovës. Këto vendime do të vlerësohen rast pas rasti dhe do të përcaktohen nga Kryetari dhe Grupi Parlamentar i PDK-së. PDK do të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Kosovës për të ngritur zërin dhe për të folur për rrezikimin që po i bëhet Kosovës nga kjo Qeveri e paaftë dhe e korruptuar edhe sipas raporteve kredibile ndërkombëtare. 4. Partia Demokratike e Kosovës ka analizuar me vëmendje draft-statutin e Asociacionit, të cilin e ka pranuar Kryeministri Kurti. Ky draf-statut krijon një nivel të ri të

pushtetit në Kosovë, pasi ka kompetenca të qarta ekzekutive. Për PDK-në, është i papranueshëm çfarëdojloj statuti, i cili e parasheh formimin e Asociacionit me kompetenca që bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, dhe që krijon një nivel të ri të pushtetit në vendin tonë. Marrëveshja e Brukselit dhe aneksi i Ohrit, që prodhuan edhe këtë draft-statut, për PDK-në nuk janë as finale e as gjithëpërfshirëse. Marrëveshja e pranuar nuk përmban njohjen reciproke de-jure, prandaj për PDK-në është e pamjaftueshme dhe mundësi e humbur për të përmbyllur konfliktin e ngrirë prej dekadash me Serbinë. PDK angazhohet dhe beson se vetëm një marrëveshje finale dhe gjithëpërfshirëse, ligjërishit e obligueshme dhe e garantuar ndërkombëtarisht, e përqendruar në njohjen reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ruan karakterin unitar të shtetit tonë, brenda rregullimit aktual kushtetues, mundëson paqe të qëndrueshme dhe avancim konkret të integritetit euroatlantik të Republikës së Kosovës. 5. Partia Demokratike e Kosovës do të filloj organizimin për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, duke mobilizuar tërë

potencialin e saj në të gjitha nivelet e organizimit partiak, për t'i sjellë vendit, pas zgjedhjeve të ardhshme, një Qeveri kredibile, të përgjegjshme dhe e cila rikthen vendin në kursin e duhur të zhvillimit, mirëqenies dhe integritetit euroatlantik. Zgjedhjet e brendshme partiake caktohen të mbahen menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Kosovës. Këshilli Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetjen e parezervë Kryetarit, Kryesisë, Grupit Parlamentar dhe të gjitha strukturave tjera partiake, për të ofruar alternativën më të mirë qeverisëse e cila nxjerr vendin nga pozicioni i rrezikshëm në të cilin ndodhet. 6. Partia Demokratike e Kosovës është e shqetësuar në lidhje me informatat për vështirësitë financiare të ekipit mbrojtës të Presidentit Hashim Thaçi. PDK e kupton se në një situatë të ngjashme janë edhe ekipet mbrojtëse të të gjithë çlirimtarëve tanë në Hagë, të cilët po mbrojnë luftën e drejtë të popullit tonë për liri. Për PDK-në, mbrojtja e të gjithë çlirimtarëve tanë në Hagë, pa dallim, nuk është çështje e interesit politik, por obligim ligjor, shtetëror dhe shoqëror. Prandaj, PDK kërkon nga institucionet e Republikës së Kosovës që të luajnë një rol më proaktiv dhe gjithëpërfshirës, për të garantuar një mbrojtje të drejtë dhe efikase për të gjithë çlirimtarët tanë. PDK, po ashtu, fton të gjithë anëtarësinë dhe mbështetësit e saj që të kontribuojnë, sipas mundësive të tyre, në fondet për mbrojtjen juridike të të gjithë çlirimtarëve të Kosovës të cilët janë në Hagë. 7. PDK do të vazhdojë të përcjellë zhvillimet e ardhshme me vëmendje të plotë dhe karshi këtyre zhvillimeve, do të shfrytëzojë të gjitha mjetet demokratike në dispozicion që të ruaj interesin e shtetit dhe të qytetarëve të Kosovës.

Zëvendëskryeministrja Rexhepi: Projekt-statuti aktual i Asociacionit krijon hapësirë për një Republikë Serbe



PRISHTINË, 4 SHKURT - Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilija Rexhepi, e quan projekt-statutin e hartuar nga komuniteti ndërkombëtar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe të dëmshëm pasi, sipas saj, krijon mundësi që të krijohet një Republikë Serbe e ngjashme me atë që ekziston në Bosnjë. Gjatë intervistës për VOA, përfaqësuesja e komunitetit boshnjak të Kosovës thotë se qeveria do ta presë qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese para se "të hartojë

një statut të ri për Asociacionin". "Si qeveri e re, me kryeministër Albin Kurtin, e kemi trashëguar këtë problem. Unë jam një nga ata që kanë votuar për themelimin e këtij Asociacioni më 2015, megjithëse kjo është një çështje prej vitit 2013, duke vlerësuar që komuniteti serb duhet të integrohet në shtetin e Kosovës, ashtu siç kemi bërë ne të tjerët, që të ketë të drejta për të jetuar, për t'u shkolluar, për të punuar. Por tani kjo është një çështje krejt tjetër, pasi vlerësoj që drafti i tanishëm u jep atyre

shumë të drejta, që pushteti ekzekutiv i Asociacionit, nëse do të themelohej, do të ishte i madh dhe kjo do ta dëmtonte shtetin tonë. Nëse do të themelohej një Asociacion i tillë krijohet mundësia që të themelohet një Republikë e dytë Serbe ashtu siç është krijuar në Bosnjë-Hercegovinë. Ne si qeveri kemi qëndrimin që mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe do ta presim qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese që të mos bëjmë asgjë që shkon në dëm të shtetit tonë", ka thënë Rexhepi.



Hovenieri thotë se ShBA-ja është e shqetësuar me veprimet e fundit të Qeverisë së Kosovës

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë thellësisht të shqetësuara për veprimet e fundit të autoriteteve të Qeverisë së Kosovës, që kanë një efekt të drejtpërdrejtë dhe negativ ndaj pjesëtarëve të serbëve etnikë dhe komuniteteve të tjera pakicë në Kosovë. Ai ka shprehur edhe shqetësimin për veprimet e Policisë së Kosovës për sekuestrimin e dinarëve serbë dhe veturës që transportonte shpërndarjen e pagesave sociale nga Serbia. Edhe Bashkimi Evropian i bëri thirrje të dielën Kosovës t'i shmangë veprimet e njëanshme, që mund t'i rrisin tensionet

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 4 shkurt - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se veprimet e fundit të Qeverisë së Kosovës, në lidhje me dinarin serb dhe mbylljen e komunave paralele serbe, janë duke rritur panevojshëm tensionet etnike dhe, si pasojë, ia kufizojnë mundësitë Shteteve të Bashkuara për ta mbështetur atë në arenën ndërkombëtare. "Shtetet e Bashkuara janë thellësisht të

shqetësuara rreth veprimeve të fundit të autoriteteve të Qeverisë së Kosovës të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe negativ në pjesëtarët e pakicës serbe dhe pakicave të tjera në Kosovë", tha Hovenieri në një komunikatë të shtunën pak para mesnatës. Në javët e fundit autoritetet e Kosovës i mbyllën katër komuna paralele serbe, në Dragash, Pejë, Istog dhe Klinë. "Këto veprime po rrisin në mënyrë të panevojshme tensionet etnike dhe, si pasojë, i kufizojnë mundësitë e Shteteve të Bashkuara për të shërbyer si

një avokate efektive për Kosovën në arenën ndërkombëtare", tha ai. Ambasadori amerikan përmendi operacionet e kryera gjatë javës nga policia e Kosovës dhe ministria e Punëve të Brendshme në zyrat e institucioneve paralele, të cilat mbështeten nga Serbia në komunën e Dragashit, Pejë, Istogut dhe Klinës, që ndodhen në pjesën perëndimore të Kosovës, si dhe në organizatën joqeveritare "Qendra për Paqe dhe Tolerancë" në Prishtinë. Ndërkohë, Hovenieri i bëri thirrje

Kosovës përsëri ta shtyjë zbatimin e një rregulloreje të Bankës Qendrore të Kosovës për ndalimin e përdorimit të dinarit serb në pagesa me para ta gatshme, derisa të vendoset një procedurë e kënaqshme në përputhje me standardet evropiane dhe derisa njerëzit të njoftohen mirë për mënyrën se si do t'i marrin përfitimet. Rregullorja e BQK-së hyri në fuqi më 1 shkurt pavarësisht prej trysnisë së madhe nga bashkësia ndërkombëtare për ta shtyrë zbatimin e saj. Hovenieri shprehur shqetësimin e tij për, siç tha, "konfiskimin e dinarëve serbë dhe një automjeti që po i transportonte ato nga Serbia për pagesa sociale" nga Policia e Kosovës të shtunën. "Jemi të shqetësuar edhe nga veprimet e policisë së Kosovës sot për sekuestrimin e dinarëve serbë dhe veturës që transportonte shpërndarjen e pagesave sociale nga Serbia. Ne kërkojmë nga autoritetet e Kosovës që të sigurojnë se individët, për të cilët janë

menduar këto pagesa të përfitimeve sociale, t'i marrin ato pa vonesë", tha ambasadori Hovenier, i cili bëri thirrje që çështjet që kanë të bëjnë me strukturat e mbështetura nga Serbia duhet të trajtohen përmes dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Njohësi i proceseve politike në vend, Ehat Miftaraj, duke komentuar deklaratën e ambasadorit amerikan, ka thënë se duhet të bëjë shumëbërllok një qeveri e udhëhequr nga amatorë për ta detyruar Ambasadën Amerikane të reagojë në orën 22:30 në fundjavë. "BQK-ja mundet mu marrë edhe me politikë nga shërbëtorët e qeverisë në këtë institucion, por pasojat politike, diplomatike, ekonomike dhe financiare do t'i bartin populli dhe Republika e Kosovës", ka thënë Miftaraj. Të premtën ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se në bashkërendim me Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe Agjencinë e Kosovës për

Haziri: Kosova humbi dy çaste për ta detyruar Serbinë ta ndryshojë Kushtetutën e saj

PRISHTINË, 4 SHKURT - Nënkrjetari i partisë opozitare në Kosovë, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, kritikon Qeverinë e Kosovës se ka humbur dy çaste të krijuara nga lufta në Ukrainë dhe konflikti i Izraelit në Gazë për t'i dhënë fund problemit të statusit të saj me Serbinë.

Në një intervistë për Zërin e Amerikës në Uashington, Haziri thotë se qeveria e kryeministrit Albin Kurti ka krijuar kriza ditore për partnerët ndërkombëtarë të Kosovës dhe se ka rritur ndjenjat nacionaliste duke ndikuar në largimin e vendit nga orientimi pro-evropian.

Ai thotë se udhëheqësit aktualë në Kosovë duhet të rikthehen te koordinimi i ngushtë me Shtetet e Bashkuara, përfshirë për çështjet si vendimi për ndalimin e qarkullimit të dinarit dhe thotë se në këtë vit zgjedhor në vendet e Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, pas të cilave, sipas tij, do të jetë e paqartë se si do të trajtohen problemet në rajon,

Kosova duhet t'i mbyllë çështjet e hapura me Serbinë për të mos mbetur, siç thotë ai, fuçi baroti.

Nënkrjetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, tha se viti 2023 ishte "vit i humbur" dhe se çastet e krijuara nga lufta në Ukrainë dhe konflikti i Izraelit në Gazë nuk u shfrytëzuan nga Qeveria e Kosovës për t'i "maksimalizuar kërkesat" në raport me Serbinë, të cilën e cilësoi si "përkrahëse dhe strehuese të grupeve terroriste". Ai shton se Qeveria e Kosovës ka humbur kohë duke u angazhuar me Serbinë dhe duke mos mbajtur fjalën ndaj partnerëve ndërkombëtarë, sjellje që, sipas tij, e çoi Kosovën drejt masave ndëshkuese.

Sipas Hazirit, tensionet e këtij viti në Kosovë kanë prodhuar kriza që i kanë detyruar partnerët ndërkombëtarë të Kosovës të merren me to në baza ditore. Ai thotë se edhe acarimi i fundit ndërmjet Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare rreth vendimit për

ndalimin e qarkullimit të dinarit në Kosovë është pjesë e së njëjtës qasje. Sipas tij, Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se "zbatimi i rregullores (për ndalimin e qarkullimit të dinarit) është obligim kushtetues", por thotë se subjekti i tij do të angazhohet për koordinim me faktorët ndërkombëtarë.

Kosova, thotë ai, duhet me çdo kusht të ketë "një bashkëpunim, një pragmatizëm, në mënyrë që t'i largojmë problemet nga tavolina, për të shkuar drejt një normalizimi". "E kaluara ka treguar qartë që në asnjë rast ShBA-ja kur ka premtuar dhe ka marrë zotime karshi popullit të Kosovës edhe Qeverisë së Kosovës nuk ka dështuar në mbajtjen e fjalës, në asnjë rrethanë. Dhe tani ne duhet me mirëbesim edhe këtë hap drejt normalizimit ta koordinojmë me ndërmjetësit ndërkombëtarë sepse BE-ja është shtëpia jonë e ardhshme", shton ai.

I pyetur nëse si ihtar i idesë së

këmbimit të territoreve si zgjidhje për çështjen e Kosovës dhe Serbisë mendon se kjo ide ka vdekur, Haziri tha se "tani në Ballkan përjashtohet ndryshimi i kufijve si opsion i mundshëm për arsye se lufta në Ukrainë ka nxjerrë probleme që prekja e kufijve të jashtëm të shteteve praktikisht është problemi kryesor".

Ai thotë se përkundër vëmendjes së përqendruar në Ukrainë dhe në konfliktin e Izraelit në Gazë, Kosova mbetet ende prioritet i lartë për bashkësinë ndërkombëtare. Por, sipas tij, "Kosova po vonohet... Kjo qeveri ka humbur dy momente të mëdha: ka humbur mundësinë për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse, obligative ligjore, ku Serbia të detyrohet ta shqyjej faqen e parë të Kushtetutës në raport me Kosovën", ka deklaruar Haziri, duke shtuar se: "Tani Serbisë po i kërkohet njohje indirekte. Së paku, në këtë shkallë duhet të maksimalizohet prapë

interesi i Kosovës. E ai është një hap i madh, që Kosova duhet ta bëjë".

Sipas tij, zgjedhjet që mbahen këtë vit në Shtetet e Bashkuara dhe në vendet e Bashkimit Evropian mund ta ndryshojnë qasjen e faktorëve ndërkombëtarë ndaj Kosovës dhe rajonit. "Është i kuptueshëm shqetësimi që Ballkani Perëndimor të mbetet si problem i hapur, apo i ngrirë, është fuçi baroti gjithmonë... dhe aq më shpejt që mbyllën problemet në rajon, aq më mirë dhe më lehtë do të jetë për një normalizim të rajonit tonë dhe perspektivës evropiane", ka pohuar Haziri.

Haziri akuzon qeverinë Kurti për largimin nga agenda pro-evropiane e Kosovës. "Kjo qeveri... duke rritur sentimentin nacional e ka ulur sentimentin evropian dhe kulturën pro-evropiane të popullit të Kosovës, priten për integrim", shton ai. Ai thotë se masat ndëshkuese të BE-së po e rrisin këtë ndjenjë anti-evropiane në Kosovë.



Inteligjencë, kanë mbyllur zyrat e strukturave paralele të Serbisë që kanë vepruar brenda Kosovës. "Me këtë rast, në Gorazhdec është mbyllur komuna ilegale e Pejës, në Osojan komuna paralele e Istogut dhe në Videjë komuna paralele e Klinës", shkroi ministri Sveçla në rrjetet sociale duke nënvizuar se koha e paligjshmërisë ka përfunduar dhe institucioni i vetëm i Serbisë brenda Kosovës do të jetë ambasada e saj në Prishtinë.

BE-ja: Kosova t'i shmangë veprimet e njëanshme që mund t'i rrisin tensionet

Bashkimi Evropian i bëri thirrje të dielën Kosovës që t'i shmangë veprimet e njëanshme që mund t'i rrisin tensionet, ndërsa shprehu shqetësimin lidhur me veprimet e fundit të institucioneve të Kosovës për mbylljen e komunave paralele të

Serbisë në Kosovë. "Statusi i këtyre strukturave është paraparë të zgjidhet në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian në lidhje me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Prandaj, Bashkimi Evropian i kërkon Kosovës t'i shmangë veprimet e njëanshme që mund t'i rrisin tensionet dhe t'i adresojë këto çështje përmes dialogut në Bruksel", thuhet në reagimin e Bashkimit Evropian. Ambasadori gjerman në Kosovë,



Jorn Rohde, i cili mbështeti deklaratën e Bashkimit Evropian, theksoi se "masat e njëanshme

vetëm sa i hedhin benzinë zjarrit dhe janë pikërisht e kundërta e uljes së tensioneve".

ROLI I ISH-TË BURGOSURAVE POLITIKE NË LËVIZJEN E PAJTIMIT TË GJAQEVE 1990-1991 NË KOSOVË

Në vitin 1990 vajzat shqiptare, të cilat kishin kaluar vite të tëra të rinisë nëpër burgje si të burgosura politike, ia hapën vetes edhe një derë tjetër të barazisë gjinore, atë të pjesëmarrjes në pajtimin e gjaqeve. Ajo kishte qenë e mbyllur për to duke filluar nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, Besëlidhja e Lezhës, e Prizrenit, e Pejës...

Lulëzim ETEMAJ

Lëvizja e Pajtimin të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë ishte lëvizja më autentike në historinë e popullit shqiptar. Rezultati i lartë i arritur gjatë veprimtarisë së saj njëvjeçare: falja e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave në mënyrë vullnetare, pa kompensim apo çfarëdo kushti të shtruar; shtrirja e saj si dhe përfshirja në të e vajzës shqiptare, ish-e burgosur politikisht, janë disa prej karakteristikave të saj më të veçanta. Në këtë punim do të trajtohet pikërisht kjo e fundit: përfshirja dhe roli i tyre, përkatësisht veprimtaria e dymbëdhjetë prej ish-të burgosurave politike në kuadër të kësaj lëvizjeje. Ato janë Have Shala, Myrvete Dreshaj, Zoge Shala, Akile Dedinca, Nafije Zendeli, Valdete Fejzullahi, Zyrafete Muriqi, Hidajete Krasniqi, Lumnije Dreshaj, Shyhrete Mala, Lumnije Azemi dhe Fikrije Musa. Qytetet e prejardhjes së tyre janë: Pejë, Istog, Fushë-Kosovë, Gostivar, Kamenicë, Ferizaj, Besianë.

I gjithë shtjellimi çon në konkluzionin se roli i vajzave shqiptare në Lëvizjen e Pajtimin të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë, i ish-të burgosurave politike, ishte shumëdimensional dhe i një rëndësie të veçantë si në aspektin human, po ashtu edhe në atë kombëtar. Ky ishte një rol jetik në kuptimin e plotë të fjalës, që nuk ndeshet asnjëherë më parë në historinë e popullit shqiptar. Si i tillë, ai është jo vetëm rol pasurues, por edhe përçues, njëherësh lartësues, i vlerave, lirive dhe të drejtave më themelore të njeriut. Madje nuk është rol i përkohshëm. Ai reflekton shembullin që duhet ndjekur jo vetëm kur në pyetje është gjakmarrja, por edhe kur temë mund të bëhet pozita e vajzës dhe gruas, posaçërisht atyre shqiptare, të drejtat e tyre të

barabarta me burrat në çdo segment jetësor, sidomos në sferën private dhe në atë publike të shoqërisë dhe kombit tonë.

Një historik i shkurtër i gjakmarrjes

Gjakmarrja ndër shqiptarë ka rrënjë historike si te të gjithë popujt e tjerë. Te ne ajo është sanksionuar nëpërmjet Kanunit të Lekë Dukagjinit, në të cilin janë përmbledhur norma dhe doke shqiptare të karakterit juridik dhe social.

“Gjaku për gjak”, “Gjaqet i la Leka si nja-nja: del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit (1)”. Kështu e ka kodifikuar gjakmarrjen Kanuni i Lekë Dukagjinit. Njëkohësisht, nëpërmjet vënies së ligjësise, Kanuni e ka barazuar edhe vlerën e gjakut, duke e konsideruar atë të njëjtë, pavarësisht prej dukjes fizike që kanë apo se çfarë shtrese sociale i takojnë i vrari dhe dorasi. Njëjtë, si gjaku i burrit, është vlerësuar edhe gjaku i gruas, në rastin kur ndonjëra vritej (2). Për më tepër, asaj, ashtu si dhe priftit, i është garantuar mbrojtja shtesë nga shtëpia e të vrarit, duke përjashtuar rënien e tyre në gjak dhe, rrjedhimisht, edhe vrasjen e tyre për ta kryer gjakmarrjen. Sepse “Grueja dhe prifti nuk biejn në gjak (3)”.

Të fortit dhe të pasurit, kështu, nuk i njihet e drejta që në emër të epërsisë dhe të vlerës së gjakut, ta vrasë të ligun apo të varfrin, pa llogaritur në të drejtën e tij për t’u gjakmarrë. Duke jetuar në një shoqëri patriarkale, pa ligje dhe pa shtet, nëpërmjet legjitimitetit të gjakmarrjes, Kanuni i Lekë Dukagjinit e ka penguar keqpërdorimin e fuqisë, qoftë ajo fizike apo ekonomike.

Krahas njohjes të së drejtës për gjakmarrje, Kanuni e ka sanksionuar edhe pajtimin e gjakut, duke e përfshirë edhe



të drejtën e të zotit të gjakut për t’ia kërkuar dorasit çmimin e caktuar të gjakut, së bashku edhe me një martinë që mund t’i pëlqejë atij. Barrë tjetër që i është ngarkuar dorasit është pagesa që ai duhet t’i bëjë shkuesit (pajtimtarit) të gjakut, e njohur si “këpuca e shkuesit të gjakut” (4), nëse ai i del në krye punës, duke e arritur pajtimin e gjakut.

Shkuesija e gjakut, e rregulluar me Kanunin e Lekë Dukagjinit, me kohë pasurohet përmbajtësisht dhe merr forma të reja. Besëlidhjet shqiptare të caktuara, si Lidhja e Lezhës, 2 mars 1444, Lidhja e Prizrenit, 10 qershor 1878, dhe Lidhja e Pejës, 23-29 janar 1899, paraqesin një formë të re për pajtimin e gjaqeve, por krejt të ndryshme nga ajo e paraparë me Kanun. Tani

pajtimi bëhej me vendime të posaçme, të nxjerra në kuvende nga drejtues të tyre, ndërsa nuk përfshinte raste të veçanta, por faljen dhe pajtimin në grup.

Duke qenë ndër shekuj me radhë pjesë e pandashme e traditës dhe duke e pasur mbështetës të fuqishëm mentalitetin patriarkal, gjakmarrja ka shënuar ndërprerjet, pezullimet apo ndalimet e saj, por nuk është zhdukur ende te shqiptarët. Faktor shtesë i mbijetimit të saj te shqiptarët në Kosovë është nxitja edhe përmes indiferencës dhe mosmarrjes së masave efektive kundër saj nga ana e pushteteve të ndryshme sllave, nën të cilat padrejtësisht ndodheshin shqiptarët e mbetur jashtë shtetit amë - Shqipërisë. Mund

të flitet për mënyrat, përkushtimin, rëniet dhe ngritjet e angazhimeve të regjimeve të ndryshme në zbatimin e projektit të Vasa Çubrilloviqit, i cili nxitjen e gjakmarrjes nga regjimi e shihte si mjet për zhdukjen e shqiptarëve (5), por jo për heqjen e tyre dorë nga realizimi i tij.

Mentaliteti patriarkal, përjashtues ndaj vajzave/grave shqiptare

Organizimi dhe mentaliteti patriarkal i shoqërisë shqiptare, pavarësisht prej shkallës zhvillimore, paraqet bazën mbi të cilën është ngritur dhe ruajtur në periudha të ndryshme historike e përbashkëta

konstante e të gjitha formave të pajtimit të gjaqeve; mungesa e përfshirjes në to të vajzës dhe gruas shqiptare, duke filluar që nga Kanuni i Lekë Dukagjinit.

“Burrat falën gjaqet”, “Atyre që falën iu takon burrëria”. Këto dy cilësime, të vjetra me shekuj, të shprehura në adresë të atyre që falin gjakun, shpërfaqin botërisht mentalitetin përjashtues ndaj vajzës dhe gruas shqiptare si dhe mohimin e të drejtës së saj për të qenë e përfshirë në aktin fisnik të faljes së gjakut. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të marrë pjesë në pajtim as në cilësinë e shkuësës, pajtimtares, as në cilësinë e falëses së gjakut.

Nuk është vetëm përjashtimi i vajzës/gruas shqiptare nga akti i pajtimit të gjaqeve njëra nga pasojat më të rënda të praktikës kanunore dhe mentalitetit patriarkal në familje apo shoqëri. Si njëra ashtu dhe tjetra, edhe përkundër ligjeve pozitive në fuqi të shtetit, me fillesë posaçërisht nga mesi i shekullit XX e tutje, kanë vazhduar ta diktojnë edhe shkallën e zhvillimit ekonomik, arsimor, kulturor, sociologjik, përfshirë edhe pjesëmarrjen e vajzës/gruas shqiptare në jetën publike, organizatat dhe veprimtaritë e ndryshme në Kosovë.

Mentaliteti patriarkal, në

njërin anë, shtypja e të drejtave njerëzore dhe mohimi i të drejtave kombëtare, në anën tjetër, janë dy skajet e zinxhirit të lidhur në këmbët e vajzave e të grave shqiptare ndër shekuj. Prandaj lufta e tyre, për dallim prej burrave, duhej të zhvillohej në dy fronte. Ato e bënë këtë luftë, e cila, në frontin patriarkal, ishte krejt e pabarabartë, për faktin se nuk e kishin përkrahjen e mjaftueshme të burrave. Në frontin tjetër, në atë të qëndresës kombëtare kundër armikut, ia arritën të jenë të barabarta me burrat edhe në goditjen që ua dha shteti, përfshirë dhunën dhe burgosjen. Kështu, të burgosurave dhe të dënuarave të para politikisht në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, 23 tetor 1945, Nesibe Zhuri, 17 vjeçe, një vit burgim; Mane Shyti, 19 vjeçe, lirohet nga aktakuza në ditën e shpalljes së gjykimit; Çeçile Krasniqi, 23 vjeçe, lirohet nga aktakuza; Mrika Gjoka, 16 vjeçe, lirohet nga aktakuza; Roza Mjeda, 18 vjeçe, një vit burgim; Luçije Bashota, 17 vjeçe, një vit burgim; Roza Cuki, 16 vjeçe, një vit burgim; Gjyljana Mateji, 18 vjeçe, dy vjet burgim, e arrestuar dhe dënuar në vitin 1945; Laura Shmani (6), 25 vjeçe, italiane, e dënuar me të, po ashtu si pjesëtare e Nacional Demokratikes Shqiptare (NDSH), me pesë

vjet burgim; Marie Shllaku, e arrestuar dhe dënuar me pushkatim në vitin 1946; Hyrije Hana (1929), e arrestuar dhe dënuar pesë 5 vjet burgim në vitin 1961 (7), po i shtoheshin pa ndërprerje bashkëvuajtëset e burgut politik, posaçërisht me intensitet të rritur pas demonstratave studentore të vitit 1981 në Kosovë, në të cilat dominonte kërkesa politike “Kosova Republikë”.

Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, përkatësisht reagimi i Beogradit zyrtar dhe mekanizmatet e tij politike si dhe atyre të ndjekjes dhe represionit në Kosovë, jo vetëm që ndikuan në shtimin e numrit të ish-të burgosurave politike, porse ato u bënë pjesë shumë e rëndësishme e Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare në Kosovës, e cila kulmoi me çlirimin e Kosovës në qershor të vitit 1999.

Një kronologji përmbledhëse e Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve dhe ish-të burgosurave politike

Në vitin 1990, vajzat shqiptare, të cilat kishin kaluar vite të tëra të rinisë nëpër burgje si të burgosura politike, ia hapën vetes edhe një derë tjetër të barazisë gjinore, atë të pjesëmarrjes në pajtimin e

gjaqeve. Ajo kishte qenë e mbyllur për to duke filluar nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, Besëlidhja e Lezhës, e Prizrenit, e Pejës, për të vazhduar me atë të Malësisë së Madhe, mbajtur më 28 qershor 1970 në Tuz, në të Rugovës mbajtur më 22 nëntor 1970 në Drelaj, deri te këshillat e pajtimit, “Islihatet”, që vepronin herë pas here, të formuara nga pleq me autoritet (8). Duke ia hapur vetvetes këtë derë, ato ua hapën edhe derën e rëndë të patriarkalizmit mijëra shoqeve të tyre vajza dhe gra shqiptare.

Në Aksionin e Pajtimit të Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave në Kosovë, të filluar më 2 shkurt 1990 nga rinia studentore e Pejës, i cili shumë shpejt u shndërrua në lëvizje gjithëpopullore, ato i hasim, në kundërshtim me Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe të gjitha traditat e deriatëhershme të faljes së gjaqeve, si:

- ideatore dhe nismëtare të pajtimit të gjaqeve;
- veprimtare në terren, për t’u bërë ftesë dhe bindur familjet e dëmtuara t’i falin gjaqet, plagët dhe ngatërresat;
- shtrirëse të pajtimit në rrethet e tjera të Kosovës përmes themelimit të këshillave të reja të pajtimit;
- drejtuese të kuvendeve të pajtimit të gjaqeve;

- koordinuese dhe drejtuese të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve;

- drejtuese të kuvendeve të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve. Më 29 janar 1990, kur në shtëpinë e Adem Grabovcit në Pejë u mor vendimi për ta filluar pajtimin e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave në Kosovë, sipas idesë paraprake të ish-të burgosurës politike Have Shala (1966), Rashiq (Pejë), bashkëvendimmarrëse, krahas ish-të burgosurve politikë, Adem Grabovci (1960), Brahim Dreshaj (1961), Nabergjan (Pejë) dhe Lulëzim Etemaj (1965), Saradran (Istog), ishte edhe ish-e burgosura tjetër politike, Myrvete Dreshaj (9) (1966), e lindur në Vrellë, komuna e Istogut, me vendbanim në Pejë, e dënuar në vitin 1985 së bashku me Have Shalën si anëtare e Grupit “IDEALI” (10). Have Shala, njëkohësisht, bën pjesë edhe në grupin e përbërë nga ajo, Adem Grabovci dhe Brahim Dreshaj që të nesërmen e marrjes së vendimit i kontaktojnë në Prishtinë dhe i ftojnë për t’iu bashkangjitur pajtimit të gjaqeve edhe profesorët Anton Çetta dhe Zekeria Cana.

(Punimi është botuar në revistën e Shkencave Albanologjike, “Studime albanologjike”, nr. 23, Shkup 2023. Fusnotat publikohen në fund të punimit/ VIJON)



Drelaj, Rugovë 1990

Rregullorja e re, BQK-ja tregon se ku dhe si mund të bëhet pranimi dhe konvertimi në euro

PRISHTINË, 4 SHKURT - Rregullorja e miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës, ku ndalohet qarkullimi i dinarit serb, po vazhdon të kundërshtohet nga shtetet e Quintit, Gjermania, Franca, Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtetet e përmendura më lart kanë kërkuar që kjo rregullore të pezullohet dhe çështja e dinarit serb të diskutohet në kuadër të dialogut.

Sipas ndërkombëtarëve, vendimi i ri i BQK-së mund të krijojë tensione ndëretnike, megjithatë BQK-ja tashmë ka publikuar rregulloren me sqarime për qytetarë. “Valuta e vetme e vlefshme të përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave me para të gatshme dhe në sistemin kombëtar të pagesave (SNP/KIPS) në Republikën e Kosovës është euro, si valutë e vetme edhe në kuptim të Nenit 11 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Neneve 16, 17 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës



së Kosovës. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është autoriteti i vetëm monetar në Republikën e Kosovës që mund

të vendosë për valutën e vlefshme për kryerjen e pagesave dhe denominimet përkatëse”, thuhet në rregulloren e BQK-së.

BQK rithekson se valutat e tjera jo euro mund të përdoren në Republikën e Kosovës si vlera për ruajtje në formë fizike apo në

llogaritë bankare në valuta jo euro, për kryerjen e pagesave ndërkombëtare në valuta jo euro dhe për aktivitetet e këmbimit valutator.


Gjithashtu, BQK-ja njofton se këmbimet valutore mund të kryhen në Republikën e Kosovës vetëm përmes institucioneve të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që ofrojnë këtë shërbim, për të gjitha valutat pa përjashtim nga aspekti rregullativ.

Po ashtu, rregullorja nuk ka vendosur asnjë kufizim sa i përket transferit ndërkombëtar të mjeteve në llogari. “Prandaj, transferi në çfarëdo valute që niset nga vendi i huaj mund të pranohet dhe konvertohet në euro në vlerë ekuivalente me kursin përkatës, sipas procedurave të vet bankës së klientit”.

Përkundër presionit nga ndërkombëtarët, BQK-ja rithekson se në Kosovë nuk lejohet përdorimi i asnjë valute tjetër.

Hapen ofertat e ankandit të parë solar foltovoltaik prej 100 MW

Në hapjen e ofertave të ankandit të parë solar foltovoltaik prej 100 MW ofertojnë 6 kompani dhe konsorciume nga Turqia, Franca, Gjermania, Zvicra, Egjipti dhe Kosova



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHKURT - Ministria e Ekonomisë ka hapur ofertat e ankandit të parë solar foltovoltaik (FV) prej 100 MW, në praninë e medieve, ku janë bërë publike emrat e gjashtë kompanive dhe konsorciumeve që kanë dorëzuar ofertat. Kompanitë dhe konsorciumet që kanë ofertuar janë: konsorciumi “Çalik-Limak” nga Turqia, kompania “Notus Energy Kosovo” nga Gjermania, përfaqësia në Kosovë, kompania “Akvo Energy SAS” nga Franca, kompania “Elswedey Electric” nga Egjipti, konsorciumi “Guris Insaat

Muhendishik” nga Turqia, si dhe konsorciumi “Orllati” nga Zvicra, përfaqësia në Kosovë.

Pas hapjes së ofertave, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, tha se pas një pune intensive në përzgjedhje të lokacionit dhe krijim të parakushteve optimale, përgatitjes së kujdesshme të dokumentacionit të ankandit, sot po shpalojmë gjashtë kompani ose konsorciume që kanë dorëzuar ofertat e tyre për ndërtimin e impiantit solar në Kosovë 100 megavatësh.

Ministrja e Ekonomisë sqaroi se gjatë procesit, përmes përgjigjeve në më shumë se 10 raunde të sqarimeve, jemi siguruar të

udhëheqim një proces të drejtë e të hapur ku të gjitha palët janë të mirinformuara dhe shtoi se deri tani, me përkrahjen e USAID-it, është zhvilluar një proces i drejtë konkurrues me transparencë të plotë që mund të thuhet lirisht është një shembull për rajonin. Ajo, po ashtu, shtoi se pranimi i këtyre ofertave sot nga investitorë seriozë dhe me përvojë në fushën e energjisë së ripërtërishme është një dëshmi e punës së palodhshme të Ministrisë së Ekonomisë dhe përkushtimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës për të ofruar një mjedis fer e miqësor për investimet e huaja. Ministrja Rizvanolli njoftoi se ky

është vetëm projekti i parë në vazhden e projekteve në dy vitet në vijim ku planifikohet të zhvillohen procedura konkurruese për ndërtimin e kapaciteteve të burimeve të ripërtërishme prej 950 megavatesh, të cilat kapin vlerën prej 1.2 miliard eurosh. “Me po të njëjtin zell do të zhvillojmë edhe projektet e tjera konkurruese, pjesë e kësaj pako, duke filluar me ankandin 150 megavatesh të erës të cilin do ta lansojmë këtë vit”, tha në fund ministrja Rizvanolli. Gjatë javëve në vijim komisioni vlerësues, i përbërë nga anëtarë të Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Mjedisit,

Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Zyrës e Rregullatorit për Energji, si dhe Operatorit të Transmisionit - KOSTT, do t'i vlerësojë ofertat kundrejt kërkesave minimale financiare, profesionale dhe teknike, siç janë përcaktuar në dosjen e ankandit.

Si fazë e dytë do të organizohet një ankand elektronik ose “e-ankandi”, ku kompanitë e kualifikuara do ta kenë mundësinë ta ulin çmimin e tyre fillestar duke garuar me njëra-tjetrën. Ofertuesi që ka dorëzuar ofertën me çmimin më të ulët në përmblyllje të “e-ankandit” do të shpallet fitues.

Nacionalistët dhe reaksionarët: Dy “partitë” shqiptare, sipas Faik Konicës

Intervistë e Faik Konicës në gazetën rumune “Universul”, XXVII, nr. 8, 10 janar 1914
Përktheu: Aurel PLASARI



– Cila është situata e brendshme politike në Shqipëri, a ekzistojnë atje parti politike dhe cilat janë programet dhe pikëpamjet e tyre? A varen programet e tyre politike nga besimet fetare?

– Në Shqipëri ka dy parti të mëdha, të cilat nuk janë ende të organizuara përfundimisht: partia nacionaliste me nuancë liberale dhe partia reaksionare konservatore, turke për nga fryma. Klasa e kultivuar në përgjithësi dhe shqiptarët e Rumanisë dhe të Amerikës bëjnë pjesë në të parën, muslimanët dhe grekomanët me shkolla të kryera në Stamboll përbëjnë të dytën. Besimet fetare nuk hyjnë në formimin e këtyre dy partive. Nacionalistët kërkonin në kohën e regjimit turk autonominë administrative dhe përdorimin e gjuhës shqipe, ndërsa unë me grupin tim deri edhe ndarjen nga Turqia. Partia reaksionare donte, përkundrazi, statu-quo dhe ruajtjen e bashkimit me Turqinë. Mbas luftës [ballkanike, – A.P.] nacionalistët e përshtatën programin duke kërkuar një shtet të ri, me konceptime të reja, i cili të shkëputej nga traditat orientale: një shtet nacional për nga fryma dhe oksidental për nga metoda. Me njerëz të rinj për këto situata të reja. Partia reaksionare kërkon vijimësinë e sistemit dhe frymës së administratës turke me gjendjen e vjetër të punëve. Nacionalistët dëshirojnë të kombëtarizojnë edhe kultin.

Të dy udhëheqësit e Shqipërisë aktuale, sa Esad Pasha aq edhe Ismail Bej Qemali, bëjnë pjesë në partinë reaksionare, duke përdorur dhe duke imponuar gjuhën turke në administratë në vend të gjuhës kombëtare, çfarë është skandaloze.

– Të dyja këto parti politike a janë dakord për emërimin e një princi

të huaj? A është princi Wied i pranueshëm nga këto parti?

– Reaksionarët, përshtat parimeve dhe pikëpamjeve të tyre, dëshirojnë një princ musliman, ndërkohë që nacionalistët, duke qenë se nuk ekziston ndonjë dinasti kombëtare, kërkojnë princ të huaj. Populli, siç është i lodhur nga kaq trazirë, duke dashur të

shpëtojë nga luftërat e brendshme dhe duke marrë vesh që princi Wied është i pëlqyeri i Fuqive të Mëdha, e ka pranuar në heshtje.

– Si mund të shpjegohet komploti më i fundit turk në Shqipëri?

– Shumë thjesht: klasat drejtuese,

të varfëruara mbas lufte dhe duke pasur nevojë për para, morën para dhe bënë komplotin në interes të atij që ka paguar dhe që do të paguajë edhe më.

– Ç’opinion keni zotëria juaj për këto dy personalitete “en vogue” [fr. në modë, – A.P.] tani në Shqipëri: Esad Pashën dhe Ismail Bej Qemalin?

– Ismail Bej Qemali, një “fileu” bizantin, i korruptuar nga shpirti dhe nga zakonet, pa ideal dhe pa parime, i gatshëm për të gjitha kompromiset. Esad Pasha është një “condotier” mesjetar, që as nuk di metodat as nuk ka skrupujt e një shtetari modern. Është nga shkolla e Abdul Hamidit, prej së cilës ka ruajtur një suvënit të gjallë. Mirëpo, është energjik dhe, po të drejtohej mirë, mund të përdorej me dobi për rivendosjen e rendit në Shqipëri. Nga natyrat e tyre do të kuptoni edhe aktet e tyre.

– Ç’parashikoni zotëria juaj për shtetin e ri shqiptar?

– Shqipëria, që del nga një krizë e tmerrshme (katër vite kryengritjesh dhe një vit pushtimi, pra pesë vite trazirash) dhe që ka qenë sunduar për katër shekuj nga brutaliteti dhe keqqeverisja e regjimit turk, ndodhet – afërmendsh – si një i sëmurë që nuk është lehtë të ngrihet në këmbë, punë që do të dojë disa kohë, porse jam absolutisht i bindur për vitalitetin, energjinë dhe të ardhmen e saj.



Tensionet në Detin e Kuq, “futet në lojë” edhe BE

Ndërsa SHBA dhe Britania e Madhe kryen sulme ajrore kundër objektivave Houthi në Jemen së fundmi, në një përpjekje për të penguar sulmet ndaj anijeve në Detin e Kuq, mbeti për shumë kohë pikëpyetje nëse do të kishte një përfshirje domethënëse të BE-së në konfliktin në rritje. Deri në një farë pike pati përgjigje të paqarta nga vendet e BE-së, duke reflektuar mosmarrëveshjet brenda bllokut për luftën midis Izraelit dhe Hamasit në Gazën e rrethuar, si dhe tensione më të gjera me Iranin dhe fuqitë e tjera rajonale. Kryediplomati i BE-së, Josep Borrell, i cili zakonisht është “i rregullt” në mediat sociale, nuk kishte komentuar mbi sulmet e fundit ajrore. Megjithatë, duket se Evropa ka vendosur të përfshihet, madje me seriozitet. Misioni mbrojtës i anijeve evropiane të goditura

takimin joformal të ministrave evropianë të Mbrojtjes në Bruksel.

“Jam i sigurt se do të merret një vendim. Jo të gjitha shtetet anëtare do të jenë të gatshme të marrin pjesë, por askush nuk do të jetë pengues, kjo është ajo që unë shpresoj. Ata që nuk duan të marrin pjesë, duhet vetëm të largohen”, për të mos penguar krijimin e misionit, tha ai. “Duam të jemi shumë të shpejtë. Shpresoj që më 17 të këtij muaji të nisë misioni. Ne duhet të vendosim se cili vend do të marrë komandën, ku do të jetë selia dhe çfarë asetesh detare do të vënë në dispozicion vendet anëtare”, shtoi ai. “Shpresoj që kjo të vendoset sot dhe ne mund ta shpallim atë,” vazhdoi Borrell. “Ne kemi një emër, Aspides, që do të thotë mbrojtës. Dhe ky është qëllimi, për të mbrojtur anijet, për të kapur sulmet dhe anijet e



konkurrojnë për të udhëhequr misionin e ri të BE-së “Aspides” për të mbrojtur anijet e Detit të

ngjarë të jetë në Larisa, Greqi, konfirmoi Ministri italian i Mbrojtjes Guido Crosetto. “Vendimi është rënë dakord dje mes të gjithë ministrave të mbrojtjes, por ende nuk është zyrtar, sepse vendimi nuk merret nga ministrat e mbrojtjes, më pas do të bëhet mbledhja e ministrave të jashtëm në datën 19 shkurt. Kjo duhet të jetë struktura përfundimtare e asaj që Bashkimi Evropian po përpqet të ecë përpara dhe mbi të cilën i ka vendosur vetes objektivin ambicioz për të sjellë të 27 vendet, gjë që duket e qartë, por nuk është rasti për këtë sektor”, tha ai në seancën e Komisioneve të Mbrojtjes të Dhomës dhe Senatit.

gjerme dje. Fregata Hessen do të lundrojë nga porti i Wilhelmshaven javën e ardhshme në drejtim të Detit të Kuq, ku pritet të marrë përsipër detyrat si pjesë e një misioni që, siç ishte planifikuar, duhet të miratohet nga Bundestag në shkurt. Fregata gjermane Hessen është e pajisur me sisteme anti-raketë dhe është projektuar posaçërisht për mbrojtjen dhe shoqërimin e anijeve të tjera dhe ka një radar të aftë për të gjurmuar një hapësirë ajrore me madhësinë e Detit të Veriut. Sekretarja e Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes Siemtje Moeller tha të enjten në Bruksel se BE-ja mund të marrë një vendim për misionin dhe se pas kësaj Bundestagu duhet të miratojë përfundimisht pjesëmarrjen e Bundeswehr-it. Për shkak të sulmit ndaj anijeve të mallrave në Detin e Kuq, pjesë të industrisë gjermane raportuan vështirësi në furnizim dhe fabrika e makinave Tesla pranë Berlinit pezulloi prodhimin për dy javë.



nga rebelët jemenas Houthi në Detin e Kuq, i quajtur “Aspides”, mund të fillojë më 17 shkurt. Kështu deklaroi Përfaqësuesi i Lartë Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Josep Borrell, në një deklaratë për shtyp pas mbërritjes së tij në

armikut, për të mos marrë pjesë në asnjë lloj aksioni kundër Houthis, por vetëm për të bllokuar sulmet ndaj anijeve”, shpjegoi ai.

Greqia në krye

Italia, Franca dhe Greqia po

Kuq nga sulmet Houthi, tha të martën një zyrtar i lartë evropian. Ministri belg i Mbrojtjes Ludivine Debonder tha se fregata e saj Louise-Marie, ka të ngjarë të jetë pjesë e misionit. Sa i përket forcave në terren, flitet për të paktën tre njësi. Selia e misionit ka të

Gjermania në lojë

Me dërgimin e fregatës së saj Hessen, edhe Gjermania do t'i bashkohet misionit të planifikuar të Bashkimit Evropian për të mbrojtur trafikun detar përmes Detit të Kuq, njoftuan mediat



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Më 17 Shkurt meçi Fury - Usyk

RIYADH, 4 SHKURT - Meçi mes Tyson Fury dhe Oleksandr Uysk, i cilësuar si “meçi i shekullit”, tashmë ka një datë të re. Ky meç, që i takon

kategorisë së peshave të rënda, fillimisht ishte i caktuar për t’u zhvilluar më 17 shkurt. Mirëpo, ditë më parë konfirmua për shtyrjen

e meçit shkaku i një lëndimit që pësoi Fury. Tani është njoftuar se përballja mes britanikut dhe ukrainasit do të zhvillohet

më 18 maj, raporton “Sky Sport”. Vendi nuk ka ndryshuar, “meçi i shekullit” do të zhvillohet në Riyadh të Arabisë Saudite.



Ylli nuk gabon ndaj Prizrenit, Peja triumfon në derbi

Elita e basketbollit të Kosovës ka sjellë ndeshje mjaftë interesante në fundjavë. Ylli fitoi ndaj Prizrenit dhe iu afrua pozitës së tretë në tabelë, derisa Vëllaznimi ka shkëlqyer ndaj Istogut. Peja e fitoi derbin ndaj Prishtinës, derisa Trepça e mposhti Bashkimin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 SHKURT - Janë zhvilluar ndeshjet e javës së 20-të në Prince Caffe Superligën e Kosovës në basketboll. KB Golden Eagle Ylli shënoi fitore ndaj Proton Cable Prizrenit me rezultat 79:67 (20:14, 23:19, 13:18, 23:14), dhe falë këtij suksesi kjo skuadër i është afruar vendit të tretë. Te Ylli u dalluan Jalen Nesbitt me 22 pikë e gjashtë kërcime dhe Gëzim Morina me 17

pikë e gjashtë kërcime, kurse te Proton Cable Prizreni më i miri ishte Arti Hajdari me 16 pikë. Golden Eagle Ylli ka 12 fitore e tetë humbje, duke u renditur në vendin e katërt, kurse prizrenasit janë në vendin e shtatë me pesë fitore e 15 humbje. Të dielën fitore bindëse ka shënuar skuadra e Vëllaznimit në përballje me Istogun, me rezultat 57:90 (7:19, 17:11, 18:26, 15:34), në javën e 20-të të Prince Caffe Superligës. Arian Azemi me 18 pikë ishte më i



miri te Istogu, derisa Myreon Jones ishte më i miri te Vëllaznimi me 24 pikë e pesë kërcime. Kuqezinjtë blindojnë vendin e pestë me nëntë fitore e 11

humbje, kurse istogasit mbetën të fundit me një fitore e 19 humbje. Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje tjera. Trepça ka regjistruar fitoren e 13-të radhazi

në Superligë, ku kësaj radhe mundi Bashkimin me rezultat 68:78 (11:24, 18:20, 24:18, 15:16). Te Bashkimi u dalluan Erik Copes me 15 pikë e tetë kërcime dhe Lejson Zeqiri me 15 pikë e shtatë kërcime, kurse te Trepça u dalluan Drilon Hajrizi me 16 pikë e shtatë kërcime, Mikaile Imusiq me 14 pikë, Darnell Edge me 15 pikë dhe Kevin Davis me 16. Ndërsa të shtunën në kryeqytet, Peja ka shënuar fitore ndaj rivaleve të vjetër Sigal Prishtinës me rezultat 66:69 (19:25, 21:11, 17:21, 9:12). Te vendasit u dalluan Shaheed Davis me 17 pikë e katër kërcime dhe Dante Clark me 16 pikë e tetë kërcime, kurse te mysafirët më i miri ishte Larry Thomas me 24 pikë e tetë kërcime dhe Justin Davis me tetë pikë e 20 kërcime.

Llapi eliminohet nga Kupa, kualifikohen Balkani, Drita dhe Prishtina

PRISHTINË, 4 SHKURT, 2024 - Janë mësuar të gjitha skuadrat çerekfinaliste të Kupës së Kosovës në futboll. Balkani ka shënuar fitore para tifozëve të vet në duel me Vëllaznimin, me rezultat 1-0. Golin e vetëm në këtë takim e realizoi Vesel Limaj, në minutën e 41-të. Një gol për ta prerë biletën për çerekfinale i ka mjaftuar edhe Dukagjinit, që ka shënuar fitore përballë Dinamos në Klinë. Për fitoren e Dukagjinit u përkujdës

Altin Merlaku, në minutën e 67-të. Drita ka fituar pa problem ndaj skuadrës së Ligës së Parë, Rilindjes 1974, me rezultat 3-0. Golin e parë e realizoi Besnik Krasniqi (12’), më pas shënoi Blend Baftiu (18’) dhe rezultatin përfundimtar e vendosi Blerim Krasniqi (54’). Ndërkohë, Llapi edhe pse kishte epërsi prej dy golash përmes Ahmed Januzit, nuk ka arritur ta menaxhojë atë dhe në fund ka pësuar humbje



REZULTATET	
Suhareka 23 - Prishtina e Re	3-1
Feronikeli 74 - Malisheva	1-3
Vjosa - 2 Korriku	4-1
Gjilani - Prishtina	0-0, (1-4 pas penalltive)
Drita - Rilindja 1974	3-0
Balkani - Vëllaznimi	1-0
Dukagjini - Dinamo	1-0
Trepça'89 - Llapi	2-2, (4-3 pas vazhdimeve)

nga Trepça'89, pas vazhdimeve, me shifrat 4:3. Ndeshja në kohën e rregullt u mbyll baras, 2-2. Kështu në çerekfinale të kupës do të luajnë: Prishtina, Malisheva, Suhareka 23, Vjosa, Balkani, Drita, Dukagjini dhe Trepça '89.

Kosova U18 në Uzbekistan kërkon biletën për Botëror



PRISHTINË, 4 SHKURT - Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll (vajzat) prej 28 shkurtit deri më 3 mars do të jetë në Tashkent të Uzbekistanit. Në Tashkent, vashat e Kosovës do ta kërkojnë biletën për

Kampionatin Botëror që mbahet në verë. Kosova U18 do të garojë në fazën ndërkontinentale të garës IHF Trophy. Paraqitjen në fazën ndërkontinentale, Kosova e ka siguruar me triumf në IHF Trophy për zonën evropiane.

Guadalupa, Guatemala, Kosova, Kaledonia e Re, Uzbekistani dhe Nigeria kërkojnë titullin e kampionit në grupmohën e të rejave (U18). Kosova do të udhëtoj me synim të qartë – kualifikimin historik në Botëror.

Të kujtojmë që deri më tani ishin vetëm hendbollistët e Kosovës U21 që janë paraqitur në Kampionat Botëror, në Spanjë. Në sportet tjera ekipore, Kosova ende nuk është kualifikuar për në Kampionat Botëror.

Arsenali triumfon në derbi ndaj Liverpoolit

Londër, 4 shkurt - Arsenali rihap garën për titull në Premier Ligë. “Skuadra e Mikel Artetës fitoi 3-1 ndaj Liverpoolit në “Emirates Stadium”, në kryendeshjen e javës në Premier Ligë, duke u ngjitur në

vendin e dytë me vetëm dy pikë më pak se “The Reds”. Saka u dha avantazhin vendasve, pasi përfitoi nga një grushtim i gabuar i portierit Alisson, që e mbylli pjesën e parë në barazim pas një autogoli të mbrojtësit

Gabriel. Në pjesën e dytë erdhën edhe dy gafa të rënda të Alisson që u shfrytëzuan maksimalisht nga Martinelli e Trossard, të cilët vulosën suksesin e topçinjve me shifrat 3-1.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

